

MA Alketa LUARI

## DOKUMENTACIONI ARBËRESH NË ARKIVIN HISTORIK TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME NË VITET 1951 – 1986

**Abstrakt:** *Marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe arbëreshëve të Italisë kanë qenë gjithmonë në qendër të vëmendjes nga qeveria komuniste para viteve '90. Interesimi i palës shqiptare për popullsinë në fjalë do të përqendrohej jo vetëm në rrafshin diplomatik, por edhe atë arsimor dhe kulturor. Pavarësisht lubatjeve në raportet ndërshtetërore Shqipëri – Itali, çështja arbëreshe nuk do të prekej, përkundrazi, do të ishte si një urë në forcimin e marrëdhënieve mes dy vendeve.*

**Fjalë kyçe:** *arbëresh, albanologjia, byro, dokumentacion, Jeronim de Rada, marrëdhënie.*

**Abstract:** *The relations between Albanians and the Arbëresh of Italy have always been in the focus of the communist government existing before '90-s. The interest of the Albanian part for the abovementioned population was concentrated not only in the diplomatic field, but also in the cultural and educational one. Despite the fluctuations in the relations between the two countries, Albania and Italy, the Arbëresh issue would not affect but on the contrary, would serve as a bridge in the strengthening of the relations between the two countries.*

**Key words:** *Arbëresh, Albanology, bureau, documentation, Jeronim De Rada, relations*

Përkundrejt epokave të cilat na paraqiten gjithmonë, nëpërmjet materialeve dokumentare, subjekti është po i njëjtë. Realiteti! Por ky realitet zbërthehet sidomos në dokumentet arkivore e cila është baza, është embrioni nga ku lind një shkrim, një dokument. Burimi arkivor të çon te e mistershmeja, te e panjohura aty ku askush nuk guxon të hulumtojë dhe kjo në periudhat më të errëta të shekullit të kaluar, veçanërisht në Evropë.

Lufta e ftohtë ishte simboli që do të ndrydhte të drejtat më themelore të njeriut, kjo në të gjitha aspektet socio-ekonomike-politike. Periudha e së ashtuquajturës *diktaturë e proletariatit*, ishte si një gangrenë në trupin e stërmunduar

të Shqipërisë. E sapo dalë nga lufta, me një prapambetje ekonomike, për mos përmendur atë kulturore, si pasojë e pushtimit otoman dhe më pas në varësi të periudhave të ndryshme që vendi kishte përjetuar, deri në vitin 1944, qeveria shqiptare ndërmerr një diktat po aq të egër si në vendet simotra të Evropës Lindore. Politika në fjalë ishte: “Gjithçka në funksion të pushtetit”. Gjithçka të përqendrohej në duart e tij dhe disa nga organizmat më delikatë dhe tepër të rëndësishëm të një qeverie përveç institucioneve të ekzekutivit janë edhe arkivat.

Tema që pretendohet të trajtohet është një temë jo shumë e rrahur, madje për ta perifrazuar saktësisht, nuk është trajtuar asnjëherë. Në periudhën post-komuniste në tranzicion, në Shqipëri, ajo ka qenë një çështje e diskutueshme dhe e rëndësishme, por në vija të përgjithshme ka lënë shumë për të dëshiruar. Tema në fjalë trajton disa nga aspektet më të rëndësishme të marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe arbëresheve gjatë regjimit komunist në vitet 1951-1986.

Si u karakterizuan marrëdhëniet përgjatë këtyre viteve? A janë vlerësuar arbëreshët siç duhet për çfarë kanë bërë në ruajtjen dhe mbrojtjen e identitetit dhe kulturës shqiptare? Cili ishte objektivi dhe synimi kryesor i qeverisë komuniste shqiptare karshi popullatës arbëreshe?

Me krijimin e Arkivit Qendror Shtetëror më 1949 fillon një periudhë e re në fushën arkivit shqiptar. Kjo pasi i gjithë dokumentacioni që gjendej në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë duhej të përqendrohej në këtë institucion. Po jo vetëm, kjo pasi qeveria shqiptare ishte e interesuar edhe për dokumentacionin që gjendej përtej kufijve, ku prioriteti kryesor ishte çështja shqiptare. Kështu, me vendim, të Këshillit të Ministrave u vendos që një pjesë e dokumenteve historikë të vendosej pranë arkivit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, ku do të përqendrohej arkivi diplomatik dhe historik.

## **Dokumentacionit arbëresh 1924 - 1942**

Fillesat e para në hulumtimin e kësaj çështjeje datojnë që në kohën e mbretit Zog, edhe pse dokumentacioni është i vakët.

Një nga dokumentet e para është një telegram i vitit 1924, i dërguar nga të rinjtë shkollorë të kolegjit të Shën Mitrit në Kozenca, në adresë të Asamblesë Nacionale, ku protestojnë për vrasjen e Avni Rustemit. Telegrami është në gjuhën italiane:

“Asamblesë Nacionale Tirana – Giovanni albanesi questo istituto...protestiamo per uccisione compagno Avni Rustemi... inviamo famiglia vive condoglianze associandosi toto corde lutto generale diletta... Giovanni Albanesi”<sup>1</sup> (Të rinjtë shqiptarë të këtij instituti protestojmë për vrasjen e Avni Rustemit... dhe i

<sup>1</sup> AHMPJ, F. Ministria P.T.T. D. 70, V. 1924, D. 70. fl. 1.

dërgojmë familjes ngushëllimet tona duke u bashkuar në zinë kombëtare...).

Po ashtu, në pak dokumente që ekzistojnë në periudhën e Monarkisë, gjendet një korrespondencë e stërnipit të patriotit madh Jeronim De Rada, me mbretin Zog, ku i kërkon këtij të fundit që një pjesë e materialeve të gjyshit të tij të dërgohen në Shqipëri, pasi siguria e veprave në fjalë ishte më e sigurt.

Gjithashtu, interesante është edhe një dokument i vitit 1942, drejtuar Mëkëmbësisë Shqiptare nga Kryeministri Mustafa Kruja, ku flitet për studentët arbëreshë të Sicilisë pranë Universitetit të Palermos:

“Kemi nderin me i parashtruar asaj së Shkëlqyeshme Mëkëmbësi Mbretnore se n’Universitetin e njoftun të Palermos ç’prej kohësh ndjekin mësimet një numër konsiderueshëm studentash të rrjedhur nga kolonitë Shqiptare të Sicilisë... në fushën e letrave, të shkencave e të politikës”.<sup>2</sup>

Gjatë okupacionit 1939 – 1944 nuk rezulton të ketë ndonjë material tjetër përveç materialit të sipërpërmendur.

### **Fillimet e para të dokumentacionit arbëresh në regjimin komunist**

Fillimet serioze nga ana e qeverisë shqiptare në çështjen arbëreshëve do të fillonin që në vitin 1951, me dokumentet e para që bëjnë fjalë për historikun e tyre, ku veçohet interesimi i palës shqiptare për materialet e figurës më të madhe të botës arbëreshe, Jeronim De Radës. Në një telegram shifër tepër sekret jepen udhëzime për blerjen e materialeve origjinale të tij në formën e dorëshkrimeve.<sup>3</sup> Ky interesim për figurën e De Radës, por dhe të figurave të tjera të fushës së letrave arbëreshe, si Anton Santori etj., do të vazhdonte për shumë vite me radhë, pasi përvetësimi i këtyre dorëshkrimeve origjinale do të ishte një fitore për qeverinë shqiptare.

Edhe në vitet e mëvonshme interesimi i qeverisë shqiptare do të vazhdonte me të njëjtin intensitet. Në vazhdim të telegrameve shifër, citoj telegramin nr. 793 që legata shqiptare në Romë i dërgon Ministrisë së Punëve të Jashtme, ku bëhet fjalë për “...blerjen e 39 letrave të tij dhe disa prej objekteve, si një violinë, kobure etj.”<sup>4</sup>.

Në vitin 1959 diskutohet vizita e Zef Skiroit, një tjetër figurë e spikatur në fushën e letrave shqipe, pranë Legatës Shqiptare në Romë, “për të diskutuar mbi blerjen e disa materialeve të De Radës dhe Dora D’Istrias”<sup>5</sup>.

Por nga ana tjetër, synimi më i rëndësishëm nga pala shqiptare ishte që përveç, interesimit në lëmin e trashëgimisë kulturore–letrare, duhej të mbizotëronte ai politik. Bashkëpunimi dhe udhëzimet që vinin drejtpërsëdrejti

<sup>2</sup> AHMPJ, F. Kryesia e Këshillit të Ministrave, V. 1942, D. 1591, fl. 3.

<sup>3</sup> AHMPJ, V. 1951, D. 262, fl. 9.

<sup>4</sup> AHMPJ, V. 1957, D. 464, fl. 3.

<sup>5</sup> AHMPJ, V. 1959, D. 534, fl. 2.

nga Byroja Politike dhe nga institucionet e tjera të larta shtetërore si Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Punëve të Brendshme, ishin: “Për gjithçka ndodh duhet të na njoftoni”! Më poshtë citoj një relacion të kryetarit të shoqatës “Miqhtë e Shqipërisë”, ku ndër të tjerash theksohet:

“Associazione amici del Albania Comitato Centrale.

Tale associazione ha per scopo di rafforzare dei rapporti politici e culturali fra It-Alb a mezzo di noi albanesi d’Italia che da 5 sec. aspettiamo il grande ritorno nella nostra antica patria.”<sup>6</sup> (Shoqata jonë ka për qëllim të përforcojë marrëdhëniet politike dhe kulturore mes Shqipërisë & Italisë mes nesh, shqiptarëve që prej 5 shekujsh presim kthimin e madh në atdheun tonë të lashtë).

Dokumenti është i firmosur nga Demetrio Mario president i Komitetit Qendror të Shoqatës. Për të vënë në dukje, ky relacion u dërgohet dhe 3 ambasadave të akredituara në Romë, asaj amerikane, sovjetike dhe jugosllave.

Ky kontekst përforcohet dhe në përgjigjen e një telegrami që Enver Hoxha i dërgon shqiptaro-italianëve të Kozencës me rastin e themelimit të shoqatës së miqësisë Itali-Shqipëri:

“I urojmë italo-shqiptarëve të Kozencës dhe gjithë Italisë që në bashkëpunim vëllazëror me demokratët progresistë italianë të korrin suksese gjithnjë e më të mëdha në luftë për mbrojtjen e paqes dhe demokracisë në vendin e vet dhe për forcimin në mes të popullit italian dhe shqiptar”.<sup>7</sup>

Siç shihet edhe në përmbajtjen e dok. Hoxha do të ishte shumë i kujdesshëm në përgjigjen e tij. Prioriteti kryesor do të ishte forcimi i miqësisë, duke anashkaluar konjunkturën ideologjike dhe politike, pasi në rrafshin diplomatik, *de jure* dhe *de facto* nuk ishin vendosur ende marrëdhëniet dypalëshe.

Në fillim të viteve ’60, marrëdhëniet mes dy vendeve, Shqipëri – Itali, ishin të prirura për t’u forcuar (edhe pse me luhate të vogla). Gjatë një vizite që një delegacion shqiptar bën në Kalabri, në relacionin me telegram shifër në nëntor të vitit 1959, përveç takimeve me popullatën vendase, veçohet dhe takimi me partizanët e atij lokaliteti:

“Ish partizanët qëndrojnë shumë mirë në përgjithësi, janë anëtarë partie, flisnin më mall të madh në L.N.C.L. për shokët e tyre e popullin tonë, sidomos për shokun Enver e shokun Mehmet...”<sup>8</sup>.

Ajo që duhet nënvizuar në këtë telegram, shihet qartë që mbizotëron pjesa politike, ku përmenden dy emrat kryesorë të qeverisë, të vetë Enver Hoxhës

<sup>6</sup> AQSH, F. Këshilli i Ministrave, V.1948, D. 324, fl. 3.

<sup>7</sup> AHMPJ, V.1953, D. 267, fl. 27.

<sup>8</sup> AQSH, Arkivi Komitetit Qendror të PPSH, V. 1973, D. 449, fl. 3.

dhe Mehmet Shehut, dhe e ku vazhdohet edhe me një nga personazhet e me të lakuar por nga kahu i kundërt ideologjik, Ernest Koliqi. Ky i fundit paraqitet në aspektin negativ duke u quajtur (gjithmonë nga popullsia vendase e zonës) si “... ministër i injorancës”<sup>9</sup>.

### **Vitet '70 dhe forcimi i marrëdhënieve me botën arbëreshe**

Pas çlirimit të vendit, me ngritjen e Institutit të Studimeve Shqiptare, në 1946, do të merrte jetë dhe Instituti i Historisë, ku formën e plotë do ta merrte në 1972 pranë Akademisë së Shkencave. Ky Institut, krahas studimeve në lëvrimin e historiografisë shqiptare, u angazhua edhe në studimet mbi popullsinë arbëreshe nëpërmjet historianëve të njohur të asaj kohe, si Aleks Buda, Stefanaq Pollo, Selami Pulaha, etj., që me studimet dhe vizitat e tyre në Kalabri etj., kanë bërë të mundur shpërfaqjen akoma më të madhe dhe njohjen më në thellësi të historisë dhe kulturës arbëreshe. Në analizat shkencore që zhvilloheshin në takimet ose konferencat dypalëshe të organizuara reciprokisht flitet shumë për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin mes popujve. Por cili ishte ekstrakti ai i vërteti i përfundimeve që nxirreshin?

Me fillimin e viteve '70 fillon një erë e re mbi çështjen arbëreshe, ajo e shkëmbimeve në fushën e albanologjisë. Në vazhdim të telegrameve shifër instruksionet që i drejtoheshin ambasadës shqiptare në Romë ishin mëse të qarta: të punohej me popullatën arbëreshe, ku përqendrimi më i madh i tyre ishte në Rajonin e Kalabrisë.

“Në Itali, siç dihet prej kohësh janë krijuar edhe qendra për studime albanologjike, nga të cilat kryesore janë: Qendra e Studimeve shqiptare në Palermo... Universiteti i Studimeve Shqiptare pranë Universitetit të Romës...”<sup>10</sup>.

Në vitin 1973 në ekspeditën gjuhësore të organizuar në Kozencë nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, në relacionin e përpiluar nga prof. Dhimitër Samara dhe Gjovalin Shkurtaj, jepen detaje shumë interesante në lidhje me këtë vizitë. Nëpërmjet pasqyrimit të aspektit letrar dhe kulturor, vihet në dukje edhe situata që mbizotëronte në vend, ku dukshëm etiketohen figurat më të spikatura të fushës së albanologjisë.

Infomacioni në fjalë është tejet i detajuar, duke filluar që me moshën e tyre, profesionin, lidhjet që kishin krijuar në aspektin profesional, shoqëror por, mbi të gjitha atë politik.

Si për ironi të fatit, pjesa më e madhe e tyre, ishin të fushës së religjionit, pra priftërinj. Kujtoj se tek arbëreshët mbizotëron riti katoliko–bizantin. Emrat

<sup>9</sup> AHMPJ, V. 1959, D. 509, fl. 5.

<sup>10</sup> AQS, Arkivi Komitetit Qendror të PPSH, V. 1973, D. 449, fl. 3.

më të lakuar janë Francesco Solano, Vincenzo Selvagi, Giuseppe Faracco, etj.

“Francesco Solano, prift nga Frascineto...Ka botuar një gramatikë të gjuhës shqipe dhe mjaft artikuj teorikë letrarë... Është rreth 55 vjeç... kërkon bashkëpunim me shkencëtarë shqiptarë. Nga sa na rezultoi, ky ka bashkëpunuar me “Shenjzat” dhe me Koliqin e Camajn. Është njeriu më i respektuar... për urtësinë dhe kulturën që ka.”<sup>11</sup>

“Fakti që për punën të gjuhës e të traditave arbëreshe... njerëzit më të interesuar vazhdojnë të jenë priftërinj, bëri që të kishim edhe kontakte me disa prej tyre. ... në Frascineto u njohëm me priftin Francesco Solano... në Plataci na priti Cicco Chidichimos. Ky prift në bisedat që patëm u shpreh hapët me shumë simpati për sukseset e arritura nga Shqipëria.”<sup>12</sup>

Në vazhdim të po të këtij relacioni përmenden edhe emra po aq të njohur të gjuhësisë, por nga kahu i kundërt ideologjik, Ernest Koliqi dhe Martin Camaj.

“...të folmet arbëreshe po humbasin edhe për arsye se shumë studiues, ndër të cilët pjesën dërrmuese e përbëjnë shqiptarët e arratisur nga Shqipëria, të tillë si Koliqi, Camaj etj., i kanë shtuar synimet shkencore në këto zona. Ngado që vajtëm gjetëm gjurmët e tyre.”<sup>13</sup>

Ideja përforcohet më tej:

“Që ditën e parë ku arritëm në S. Demetrio Corone u gjetëm përballë një opinioni të përpunuar nga propaganda antishqiptare... dilnin pyetjet lidhur me vrasjen e priftit Shtjefën Kurti, ...edhe njerëzit e thjeshtë me të cilët u takuam na pyesnin vazhdimisht dhe me gjera të tjera që përkasin ateizmit në vendin tonë.”<sup>14</sup>

Në një telegram Dëshifrim, që i drejtohet personalisht Enver Hoxhës nga ambasada shqiptare në Romë, ndër të tjerat thuhet:

“Ditët e fundit të gjitha sindikatat e fshatrave arbëreshe kanë vendosur që kolegjin e S. Demtrio Koronës ta kthejnë në qendrën e studimeve shqiptare... Këtë qendër e shohin si mundësinë kryesore për ruajtjen e gjuhës dhe zakoneve arbëreshe... në disa fshatra shihen programet televizive tonat...”<sup>15</sup>

---

<sup>11</sup> AHMP, V. 1973, D. 751, f. 27.

<sup>12</sup> *Idem.*

<sup>13</sup> *Idem.*

<sup>14</sup> *Idem.*

<sup>15</sup> *Idem.*

Edhe në fushën e kulturës, interesimi nga të dyja palët ishte tejet i madh. Në telegramin nr. 103, të vitit 1972 shtrohet koncepti mbi pjesëmarrjen e një grupi artistik folklorik arbëresh në Shqipëri.

“Mendojmë të ftojme një grup artistik të ndonjë komune arbëreshe, p.sh. atë të S. Giorgio Albanese të Lungros... grupi mund të jetë 15-20 dhe të qëndrojë këtu 10-15 ditë. Shpenzimet e qëndrimit do të jenë tonat...”<sup>16</sup>

Në vitin 1977 për herë të parë u mundësua në Shqipëri ardhja e një grupi studentësh arbëreshë të shoqëruar nga prof. F. Solano. Në të gjitha telegramet shifër që dërgoheshin nga legata jonë në Romë jepeshin informacione të hollësishme për miqtë që do të vinin nga përtej detit. Si në çdo informacion, mbizotëron biografia e secilit sidomos për bindjet politike.

“Nga 13 studentët e studentet që erdhën më professor Solanon, 5 ishin nga fshati Shën Mitri i Koronës. Për nga bindjet politike një pjesë syresh ishin demokristianë, një pjesë me qëndrim politik të papërcaktuar dhe 4 prej tyre thoshin se ishin komunistë...”<sup>17</sup>

Mbikëqyrja nga nga ana e policisë shqiptare, do të ishte i rreptë, por pa rënë në sy. Por qëndrimi i studentëve në fjalë ka qenë tepër korrekt.

### **Shkëmbimet arsimore dhe kulturore deri në vitin 1990**

Me fillimin e viteve ‘80 e tutje marrëdhëniet do të zgjeroheshin jo vetëm në fushën e arsimit, por edhe në atë të kulturës, ku grupet arbëreshe vijjnë në vendin tonë në kuadër të koncerteve të ndryshme por sidomos të festivalit folklorik në Gjirokastrë.

“Rrethi kulturor arbëresh në Cività Kalabria, na ka ftuar për të marrë pjesë në festivalin popullor që do të bëhet në 13 prill.... Jemi dakord që të merrni pjesë në festivalin folklorik. Shfrytëzoheni këtë rast për të përcaktuar më mirë personat kalabrez që duhen ftuar.”<sup>18</sup> 17)

Gjithashtu qeveria shqiptare për të rritur kredibilitetin e saj dërgon ansamble të ndryshme muzikore ku priten me entuziazëm nga popullsia vendase.

“Interesimi i arbëreshëve në tërësi për vendin tonë ka ardhur nga viti në vit duke u shtuar... përfaqësia jonë... është përpjekur për të përmirësuar punën e saj propagandistike jo vetëm nëpërmjet shpërndarjes së materialeve revistave botimeve etj., ... por edhe nëpërmjet shtimit të kontakteve ... si shfaqje filmash... dërgimin në vendin tonë të grupit folklorik arbëresh...”<sup>19</sup>

Pas vdekjes së Enver Hoxhës në 11 prill 1985, për hir të së vërtetës çështja arbëreshe nuk u zbeh, por mori dimensione më të gjera në trajtimin e aspekteve

<sup>16</sup> AHMPJ, V. 1972, D. 652, fl. 3.

<sup>17</sup> AHMPJ, V. 1977, D.569/1, fl. 40.

<sup>18</sup> AHMPJ, V. 1971, D. 569/1, fl. 1271.

<sup>19</sup> AQSh, Arkivi Komitetit Qendror të PPSH, V. 1973, D. 449, fl. 3-4.

të ndryshme.

“Në programin e shkëmbimeve kulturore me Italinë parashikohet pritja në vendin tonë e një grupi 30-35 vetash për frekuentimin e kurseve të gjuhës shqipe. Njëkohësisht ne dhe Universiteti i Tiranës “Enver Hoxha” ka marrë letra nga shefi i katedrës së gjuhës shqipe në Universitetin e Kalabrisë, Francesco Altimari, ku flitet për kërkesën e trajnimit në informacion.”<sup>20</sup>

Në përfundim mund të thuhet se dokumentacioni arbëresh ka një larmi në përmbajtjen e tij, siç u përmend edhe në hyrje të punimit, duke qenë një temë që trajtohet për herë të parë, u trajtua në vija të përgjithshme duke prekur disa nga çështjet më kryesore në analizën e saj, kjo pasi dokumentacioni nga viti 1986 e deri më sot është ende i klasifikuar.

### **Bibliografi:**

Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, F. Ministria P.T.T., V. 1924, D. 70,  
Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, F. Kryesia e Këshillit të Ministrave, V. 1942, D. 1591.

Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1951, D. 262.

Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1953, D. 267.

Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1957, D. 464.

Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1959, D. 509.

Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1959, D. 534.

AHMPJ, V. 1971, D. 569/1, fl. 1271.

Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1972, D. 652.

Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1973, D. 751.

Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1977, D. 569/1.

Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1985, D. 1159.

Arkivi Qendror Shtetëror, F. Këshilli i Ministrave, V. 1948, D. 324.

Arkivi Qendror Shtetëror, Arkivi Komitetit Qendror të PPSH, V. 1973, D. 449.

Arkivi Qendror Shtetëror, Arkivi Komitetit Qendror të PPSH, V. 1973, D. 449.

Arkivi Qendror Shtetëror, Arkivi Komitetit Qendror të PPSH, V. 1973, D. 449.

---

<sup>20</sup> AHMPJ, V. 1985, D. 1159, fl. 2.

Marje 29/11 1924

SHTETI SHQIPTAR

TELEGRAM TRANSIT

U-transmetue

Zyrtarë 10/11 ora

datë 29/11 ora

Nëpunsi

CILESI

PER

ORA

SHENIMET E QËLLSHME

Gjerman Demetrio Carone

Assembles Nazionale Gjermana - Gjermani albanesi questo istituto affranti pericola immatura fervente asseritore liberta albanese avani fuakun protestano prositoria uccisione compagno ricordato iniquita mano traditrice amante oscurantismo inviano famiglia grande salimata vive condoglianza associandosi toto corde lutto generale diletta patria

Gjermani albanesi

AHMPJ – F. Drejtoria Përgjithshme P.T.T. D. Nr. 70, V. 1924, fl. 1.

2999

Shifrim

Koncepti Legatës Shqiptare - Romë

Gjegje tregjtit N: 137 datë 2 Gusht 1951 -

Drejtori dhe tërhipsi materiale e J. De Radës -

Drejtori dhe lloparine -

Mihal

M. L. J.

Tepër Sekret

Të shkruhet vetëm me dorë dhe me shkrim të

U merr në dorë	Ker fllorë shifrimi	Ker mbarojë shifrimi	Plima
Data	Ora	Data	Ora

Telegrami shifër mbi blerjen e materialeve të Jeronim De Radës. AHMPJ – D. 17, V. 1951, fl. 9.

Te rikthehet në organin e shifrës jo më vonë se 5 minuta  
ndalohehet me nxjerrje kopje

TEPËR SEKRET  
Nr. Fletës 120

## DESHIFRIM

Nr. 5944 Nga Roma Mf. 026693

---

**PËR SHËNIME**

Mora njatim  
data  
ora  
Firma

**PËR MBATJJA**

Nr. 609 Data \_\_\_\_\_

**PJESA E TRETE TELIT Nr. 609**

Ata ruajnë gjuke, zakonet shqiptare me gjithë vjetet e fundit nga influenca e kohës në adonje katund ka filluar të humbas gjuke etj. Ish partizanet qendrojnë shumë mire, në përgjithasi janë antar partije, flisnin me mall të math me L.N.C.L. për shoket e tyre e popullia tone, si domos për Sh. Bayer, Shokun Mehmet dhe komandantet e komisarët e reparteve të tyre. Dame peshqeshe simbolike si dhe m terjale propa-gandistike. Nga kriminelat aratisur Koliqi kish qene kohet e fundit, për nuk kish gjetur mbeshatetje veç se me elementet klerike dhe adonje fashist, populli e ka fishkelluar duke quajtur si ish ministri i injerances. Vizion

KOCO

U-muar në dorëzim		Kur filloj deshifrimi		Kur mbaroj deshifrimi		Firma e Shifrantit	Firma e kontrolluesit
data	ora	data	ora	data	ora		

Telegrami nr. 609 i deshifruar, dërguar MPJ mbi vizitën e një delegacioni shqiptar në Kalabri. AHMPJ – D. 509, V. 1959, fl. 7.

- 8 -

përmbledhje me materiale folklorike. Është rreth 35 vjeç.

Giuseppe Ferrace  
prift nga Vakarico, punon në San Denetrio Corone. Drejton grupin folklorik "Zjarri" dhe revistën me të njëjtin titull. Kërkon ketë bashkëpunim shkencor me shkencëtarët shqiptarë. Lëvdon punimet shkencore të shkencëtarëve shqiptarë dhe shprehet kundër Koliqit, Gvadigliones, Gangales etj. Na tha se e kritikojnë vazhdimisht si "të kuq". Është 35 vjeç.

Francesco Solano  
prift nga Franscineto, punon po në Franscineto. Ka botuar një gramatikë të gjuhës shqipe dhe mjaft artikuj teoriko letrarë për probleme të letërsisë e gjuhës arbëreshe. Është rreth 55 vjeç, njëj shumë gjuhë të huaja, kërkon bashkëpunim me shkencëtarët shqiptarë. Nga na na rezultoi neve, ky ka bashkëpunuar me "Shejzat" dhe me Koliqin e Camaj. Është njeriu më i respektuar nga studjuesit arbëreshë për urtësinë e kulturën që ka.

Emanuel Giordano  
prift nga Ejanina; ka vizituar Shqipërinë: Pota "Zëri i arbëreshëve", ka botuar "Fjalori i arbëreshëve të Italisë" etj.  
Në katundet arbëreshe që vizitua pamë se janë edhe shumë të rinj që kanë mbaruar studimet për gjuhë e letërsi dhe kanë paraqitur tema disertacioni nga fusha e gjuhës ose folklorit arbëresh. Megjithatë se pas mbarimit të shkollës ata nuk janë shquar për veprimtari shkencore; ne pamë se disa prej tyre punojnë dhe mund të kontribuojnë. U shoqëruan me neve dhe na ndihmuan. Ndër ta mendojmë se duhen mbajtur lidhje me këta:

Alfio Moga  
29 vjeç nga San Benedetto Ulano, punon në Vakarico, bashkëpunon me V. Selveggia; ka mbrojtur lauren me një punim për folklorin arbëresh

Giorgio Morano  
mësues nga Vakarico, ka mbledhur shumë material leksikor dhe punon për një fjalor të së folmes së Vakarizzos. Dëshiron të bashkë-

Të dhënat mbi meshtarët e Rajonit të Kalabrisë, të zonave të ndryshme. AHMPJ – D. 751, V. 1973, fl. 27.